



In medias res

Etapa përgatitore në hartimin e kurrikulave

Faza përgatitore është faza e parë e domosdoshme në hartimin dhe zhvillimin e kurrikulave, përkatësisht në reformën kurrikulare. Në të vërtetë kjo fazë paraqet themelin kryesor pa të cilën nuk ka reformë kurrikulare. Në këtë fazë bëhet analiza e nevojave, mbledhja dhe grumbullimi i informacioneve për atë se çka fëmijët, nxënësit, prindërit, mësime dhënësit, profesionistët, punëdhënësit, politikanët dhe faktorët tjerë mendojnë se është e nevojshme të ndryshojë, të futet si gjë e re ose të hiqet nga sistemi i edukimit.

Analiza e nevojave arsimore, studimi i gjendjes, përkatësisht njohja me shëndetin arsimor është shumë komplekse.

Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është organizimi i hulumtimeve shkencore më qëllim të grumbullimit të informacioneve relevante për aspektet e ndryshme të sistemit të arsimit, pra në kuadër të kësaj edhe të kurrikulave.

Tani, kur në Kosovë është duke u bërë Reforma kurrikulare është dashur të merret parasysh ndërmjet tjerash edhe studimi i bërë nga Instituti për Edukim i Universiteti të Londrës i angazhuar nga UNICEF dhe me pajtimin Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe të Teknologjisë në të cilin ndërmjet tjerash thuhet: *"Bashkësitë kulturore janë të larmishme. Në mesin e tyre ekzistojnë bashkësi në të cilat flitet gjuha serbe dhe feja e të cilëve është feja ortodokse; ligji i tyre për arsim, kurrikuli për shkollën fillore, tekstat dhe administrata, duke e përfshirë këtu edhe pagesat e mësime dhënësit, vijnë nga Beogradi. Këtë sistem të njëjtë e zbatojnë edhe Goranët, gjuha e të cilëve është gjuhë serbe, por feja e të cilëve është feja myslimane. Romët, të cilën gjuhën e tyre e mësojnë në shtëpi, tërësisht varen nga vendi ku jetojnë, por, po ashtu, shkollën e vijnë në gjuhë serbe. Romë ka të fesë myslimane dhe ortodokse. Bashkësitë në të cilat flitet gjuha turke zbatojnë kurrikulin e ri nëntëvjeçar kosovar në shkollat fillore në mësimin në gjuhën turke. Bashkësitë në të cilat flitet gjuha boshnjake, ngjashëm me këtë zbatojnë kurrikulin kosovar nëntëvjeçar për shkollën fillore në gjuhën boshnjake, ndërsa i takojnë fesë myslimane. Në disa vendbanime ata përdorin kurrikulin serb. Bashkësitë që flasin gjuhën kroate ata i takojnë besimit romano – katolik. Ashkalitë dhe egjiptianët, paraardhës të vjetër të Romëve, jetojnë në bashkësi të ndara dhe gjuhën e mësojnë në shtëpi dhe, varësisht ku jetojnë përfshihen në sistemin e në të apo të vjeçarë fillor duke u detyruar të mësojnë gjuhën, qoftë në gjuhën shqipe, qoftë në gjuhën serbe. Këto grupe i përkasin besimit islam. Bashkësitë rome janë të vetmet që janë detyruar të mësojnë gjuhën plotësuese e që të përcjellin programin shkollor. Kjo mangësi pengon shumë argumentin për mësim në gjuhën amtare në bashkësinë rome[...], Tensioni ndëretnik me të vërtetë është një pengesë dhe burim potencial i konflikteve me implikime të drejtpërdrejta për lirinë e lëvizjes dhe qasjen barabartë në shërbimet edukative"*¹

Këto gjetje tregojnë se në hartimin e kurrikulave prioritet duhet dhënë krijimit të sistemit të integruar të arsimit me përmasën shumëkulturore në të cilin të gjitha bashkësitë etnike dhe kulturore kanë mundësi t'i plotësojnë nevojat e tyre të ndara. Por që në të njëjtën kohë mësojnë për kulturën, traditën e bashkësive të tjera etnike. Njohja e kësaj imponon nevojën e nxitjes së debateve dhe të diskutimeve në mënyrë që kurrikuli të shprehet aspiratat e të gjitha bashkësive etnike dhe kulturore.

Në identifikimin dhe analizën e nevojave arsimore hulumtimet dhe format të tjera të identifikimi të tyre, për të cilat do flasim në vazhdim, sigurohet shtigjet drejt të cilave duhet të ecin reformat kurrikulare.

Shkroi: Halim Hyseni

¹ Gundura, prof. J. & Peffers, J. (2006) Arsimi cilësor për të gjithë në Kosovë, UNICEF, Prishtinë, f. 15 -16

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Gjatë muajit nëntor janë themeluar edhe 26 Ekiye Komunale për Grante Shkollore (EKGS) dhe një ekip regional për rajonin e Mitrovicës veriore, me çka u kompletua themelimi i këtyre ekipeve për secilën komunë të Kosovës. Këto ekipe kanë për detyrë që të listojnë shkollat e komunës së tyre në bazë të indikatorëve dhe kritereve të përcaktuara në manualin e Granteve për Zhvillimin e shkollave dhe të propozojnë shkollat të cilat kanë mundësi të përfitojnë një grant nga MASHT.

■ Pas themelimit, të gjitha EKGS kanë mbajtur takimet e tyre të punës, kanë listuar shkollat dhe kanë propozuar shkollat që mund të përfitojnë gjatë rundit të parë të ndarjes së granteve për zhvillimin e shkollave. Varësisht nga alokimet buxhetore sipas komunave, në rundin e parë nga të gjitha EKGS janë propozuar 116 shkolla në mbarë Kosovën.

■ Këshilli për aprovimin e granteve shkollore ka aprovuar të gjitha shkollat e propozuara duke respektuar kështu punën e bërë nga EKGS. Pas aprovimit të listës së shkollave, KEC ka arritur të mobilizojë të gjitha kapacitetet për fillimin e ciklit të trajnimeve për përfaqësuesit e shkollave përfituese. Puna jashtëzakonisht profesionale e BPT ka bërë që informimi për shkollat përfituese të shpërndahej te të gjitha EKGS dhe te drejtorët e shkollave përfituese. BPT kanë informuar drejtorët e shkollave për programin e granteve dhe kanë kërkuar që secili drejtor i shkollave përfituese të delegojë dy përfaqësues të shkollave për të marrë pjesë në trajnimin e parë 2-ditorë të organizuar për hartimin e planit zhvillimor të shkollës.

Trajnimet janë mbajtur më 22-23 nëntor në Prizren, më 24-25 nëntor në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, ndërsa më 25-26 nëntor në Ferizaj. Nga fletë vlerësimet kuptohet që pjesëmarrësit kanë qenë shumë të kënaqur me programin e trajnimit, përgatitjen e trajnerëve, si dhe cilësitë e njohurive që kanë përfituar. Të gjitha shkollat përfituese do të prezantojnë draftet e PZhSh të tyre më datën 15 dhjetor.

KOSOVISION Contest

■ Gjatë këtij muaji është bërë përzgjedhja e projekteve më të mira fituese në raundin e tretë të KOSOVISION CONTEST. Pas punës tre ditore të jurisë në të gjitha regionet e Kosovës dhe pas zgjedhjes së një numri të konsiderueshëm të punimeve si më të mundshmet për fitore, ekipi nga Zvicra ka bërë edhe vlerësimin final dhe ka bërë zgjedhjen e 83 klasave në këtë vit. Për të parë klasat fituese të projektit, ju lutem vizitoni ueb-faqen www.kosovision.org.

■ Gjithashtu, gjatë këtij muaji është bërë edhe organizimi i ceremonive lokale. Secili regjion ka organizuar ngjarjet lokale ku edhe janë shpallur fituesit e KOSOVISION CONTEST për herë të tretë. Ngjarjet lokale kanë pasur përfshirje të madhe të mediave. Të ftuar ishin nga 150 deri në 200 pjesëmarrës në secilin regjion.



Pjesëmarrja e prindërve në vendim marrje në shkollë

■ Në kuadër të projektit "Pjesëmarrja e prindërve në vendim marrje në shkollë" gjatë muajit tetor dhe nëntor janë mbajtur trajnime me Këshillat e prindërve të shkollave fillore në rajone të ndryshme të Kosovës. Gjatë tetorit u organizuan trajnimet në Pejë, Mitrovicë, Prishtinë, Prizren. Ndërsa gjatë nëntorit u organizuan në Gjilan dhe në Gjakovë.

■ Të gjithë këshillat e prindërve u trajnuan për Drejtësinë Shoqërore dhe Avokim. Pjesëmarrësit patën mundësi të njihen me format e ndryshme të avokimit. Në fund të trajnimeve të gjitha shkollat pjesëmarrëse kanë dale me nga një plan të veprimit apo fushatë të avokimit të përgatitur në lidhje me një çështje të cilën e kanë caktuar gjatë ditëve të trajnimit.

Hap pas Hapi

■ Me datat 11,12,13,14,15 tetor në Mitrovicë në bashkëpunim me organizatën QDShC "Koralet" u organizua trajnimi bazik "Hap pas hapi" për edukatorët që punojnë për fëmijët parashkollor. Në këtë trajnim u certifikuan 21 pjesëmarrës.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit të kaluar. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO). Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education,

Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Gjatë majit nëntor u mbajt takimi i tretë i Komitetit Drejtues të Projektit ku u prezantua progresi i bërë nga projekti gjatë periudhës raportuese Korrik-Shtator 2010 si dhe u diskutua plani për përudhen raportuese të radhës. Të gjithë anëtarët e Komitetit Drejtues të Projektit mirëpritën progresin e arritur në të tre komponentët e projektit, veçanërisht në Komponentin e parë në mbështetje të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë, dhe në Komponentin e dytë në mbështetje të procesit të zhvillimit të kurrikulumit të ri të Kosovës.

■ Gjithashtu gjatë muajit nëntor, pas lansimit në gjuhën angleze, është lansuar edhe versioni në gjuhën Shqipe i uebfaqës së projektit (www.eu.eduswap-ks.org) ku janë të publikuara/vazhdimisht publikohen të gjitha dokumentet e prodhuara nga projekti. Një lidhje për uebfaqen e projektit gjithashtu gjendet në uebfaqen e MASHT-it.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Gjatë këtij muaji, Projekti EU-SIMRAES ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me 6 qendrat e komuniteteve RAE, si dhe me OJQ-të partnere që implementojnë komponentin e arsimit.

■ Gjatë këtij muaji dhe muajit të ardhshëm është duke u punuar në drejtim të hartimit të planeve vjetore për qendrat, si dhe dizajnimin e programeve të cilët do të implementohen në këto qendra. Këto parashihet të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me stafin e qendrave (respektivisht koordinatorët). Sidoqoftë, duke e ditur se ende jemi në pritje të

nënshkrimit të MeM dhe miratimit të Raportit Nismëtar, KEC është përqendruar të marrë informata paraprake se si këto programe implementohen nga institucionet tjera parashkollore. Për këtë qëllim janë vizituar institucionet në vijim:

■ Në Prizren është vizituar shkolla Ibrahim Fehmiu, përkatësisht programi parashkollor në këtë shkollë, si dhe Institucioni Parashkollor “Mollëkuqja 2” që gjendet në një objekt privat po ashtu në Prizren. Në Prishtinë është vizituar SOS fshati. Gjatë vizitave që janë bërë në këto institucione, përgjegjësit e tyre dhe pedagogët na kanë informuar në lidhje me aktivitetet e tyre, programet dhe planet njëvjeçare që i implementojnë në këto qendra. Në bazë të informatave të paraqitura shihet se të gjitha qendrat e zbatojnë plan-programin e MASHT, megjithëse kanë bërë disa ndryshme, në mënyrë që t’ia përshtatin ato specifikave dhe nevojave të tyre konkrete.

■ KEC është duke bashkëpunuar ngushtë me OJQ-të dhe agjencitë tjera partnere që i ndihmojnë komunitetet RAE. Duhet të përmendet takimi koordinues, i mbajtur në Mitrovicë, më 4 Nëntor me Mercy Corps, Caritas, DRC, UNICEF, etj. Ky takim është vazhdimësi e takimit të parë, dhe këtë herë u diskutuan shumë çështje në mënyrë më specifike. KEC në këtë drejtim shtoi se në momentin e nënshkrimit të MeM dhe miratimit të Raportit Nismëtar nga ZNKE, do të fillojë menjëherë implementimin e programeve të veta. Në lidhje me këtë pikë të gjitha OJQ-të pjesëmarrëse premtuan se do ta ndihmojnë projektin, duke plotësuar aktivitetet projektit me resurset e veta, si dhe do të ndihmojnë në bashkëpunim me OJQ-në partnere në Mitrovicë, RADC, në hartimin e planit njëvjeçar për këtë qendër.

Përgatiti: Petrit Tahiri